



Në bazë të nenit 6, paragrafit 6.5. dhe 6.6 Statutit të Federatës së Tenisit të së Kosovës, Kuvendi i FTK-se, në mbledhjen e mbajtur me date 17.11.2022 miratoi:

RREGULLORE NR. #10
PËR
PUNËN E KOMISIONIT TË ANKESAVE



Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore, përcaktohen përgjegjësitë, fushëveprimi, rregullat, procedurat e punës së Komisionit të Ankesave dhe procedurat e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Federatës së Tenisit të Kosovës (në testin e mëtejme “anëtarët e FTK-së”), Komisionit të Ankesave dhe personat tjerë të cilët janë subjekt i trajtimit në bazë të dispozitave të kësaj Rregullore.

Neni 3 Parimet

- 3.1. Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera;
- 3.2. Parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me sportin e Tenisit.
- 3.3. Parimi i shprehjes së vullnetit të lirë, mirëkuptimit dhe tolerancës së anëtarëve të FTKsë.

Neni 4 Përbërja e Komisionit të Ankesave

- 4.1. Komisioni i Ankesave përbëhet nga 3 anëtarë ku njëri nga ta zgjedhet kryesues.
- 4.2. Kandidati i cili merrë më shumë vota, automatikisht është edhe kryesues i Komisionit.
- 4.3. Në rast të numrit të votave të barabartë, Kryesuesi zgjidhet nga Kuvendi me aklamacion
- 4.4. Mandati i Komisionit zgjatë sipas nenit 9, paragrafit 9.1 të Statutit të FTK-së.
- 4.5. Kandidatët për Anëtarët e Komisionit propozohen nga Delgatët e Kuvendit, preferohet të kenë një arsimim juridik ose përvojë në çështjet juridike.
- 4.6. Për anëtar të Komisionit, mund të propozohen edhe personat që nuk janë delegatë të Kuvendit të FTK-së.



- 4.7. Një anëtar i Komisionit nuk mund të mbajë e as të marrë një pozicion në organet e tjera të FTK-së
- 4.8. Kandidatët që kanë numër më të madhë të votave në raundin e parë, zgjidhen në Komision. Në rast të numrit të barabartë të votave në raundin e parë, atëherë votimi në raundin e radhës bëhet me aklamcion.

Neni 5 Funksionimi

- 5.1. Komisionit i Ankesave është organ vendimmarrës dhe i pavarur i cili zgjedhet nga Kuvendi dhe vepron në përputhje me aktet normative të FTK-së dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- 5.2. Komisioni i Ankesave bënë shqyrtimin dhe vendos ndaj:
- 5.3. Ankesave të parashtruara kundër vendimeve të gjitha organeve të FTK-së;
- 5.4. Ankesave të parashtruara kundër vendimeve të të gjitha Komisoneve të FTK-së, që emërohen nga Bordi i FTK-së.

Neni 6 E drejta e ankesës

- 6.1. Ankesa në Komision mund të parashtrohet nga çdo anëtar i FTK-së apo përmes të autorizuarit të tij.
- 6.2. Ankesa ndaj organeve të FTK-së, duhet të parashtrohet brenda pesëmbdhjetë (15) ditëve, nga data kur pala ka pranuar aktin përkatës administrativ.
- 6.3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar nga paragrafi 2 i këtij neni, është tre (3) muaj nga dita e marrjes së aktit përkatës administrativ.
- 6.4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet deri në një (1) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.
- 6.5. Pala mund të ushtrojë vetëm një herë ankesë tek Komisioni i Ankesave për të njëjtën çështje.

Neni 7 Kompetencat

Komisioni i Ankesave ka këto kompetenca:

- 7.1. Pranoj ankesën dhe ndryshoj vendimin e organit vendimmarrës të FTK-së;
- 7.2. Pranoj ankesën dhe konfirmoj vendimin e organit vendimmarrës të FTK-së;



- 7.3. Kthej ankesën për rishqyrtim te organi vendimmarës të FTK-së;
- 7.4. Refuzoj ankesën në rastet kur ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor apo është e pabazuar e parashtruar në kundërshtim me Statutin, këtë Rregullore dhe aktet normative përkatëse në fuqi.
- 7.5. Pretendimet e palëve nuk janë detyruese për Komisionin e Ankesave, pasi që Komisioni është organ i pavarur dhe i njëjti mund të ndërmarrë njërin nga veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
- 7.6. Vendimet e Komisionit të Ankesave janë përfundimtare brenda FTK-së.

Neni 8 Mbajtja e seancës

- 8.1. Seancat e Komisionit të Ankesave mbahen sa herë që Kryesuesi i Komisionit e vlerëson të nevojshme ose kur kërkohet me dispozitat e kësaj Rregullore.
- 8.2. Përgatitjen e seancës së Komisionit e organizon Kryesuesi i Komisionit.
- 8.3. Propozimin e Rendit të ditës për seancën e Komisionit e përcakton Kryesuesi, sipas iniciativës së vet apo sipas propozimit të anëtarëve tjerë të Komisionit.
- 8.4. Ftesat për seancë bëhen në formë elektronike.

Neni 9 Parashtrimi i Ankesës

Pala mund të dorëzojë ankesë në Komision si në vijim:

- 9.1. Në mënyrë fizike, personalisht ose nga i përfaqësuesi i tij;
- 9.2. Përmes postës së zakonshme apo të certifikuar; ose
- 9.3. Përmes formës elektronike e cila duhet të konfirmohet se është pranuar nga administrata e FTK-së.
- 9.4. Sekretari i Përgjithshëm është i detyruar që për ankesat e pranuar dhe të caktojë numrin e regjistrimit dhe protokollit, si dhe datën e pranimit të ankesës.
- 9.5. Pas regjistrimit të ankesës, Sekretari i Përgjithshëm në ditën e njëjtë e përcjell ankesën tek Kryesuesi i Komisionit të Ankesave.
- 9.6. Ankesa parashtrohet me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe duhet të jetë e nënshkruar nga ankuesi ose i përfaqësuesi i tij.

Neni 10 Pranueshmëria e ankesës

Ankesa e parashtruar duhet të përmbajë këto të dhëna:

- 10.1. Emrin, mbiemrin, e-mailin, adresën dhe numrin e telefonit të ankuesit;



- 10.2. Të dhënat për aktin administrativ të nxjerrë të organit të FTK-së apo të munguar i cili kontestohet;
- 10.3. shkaqet e ankimimit, pretendimet dhe çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga ankuesi.
- 10.4. Pala e cila parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave, duhet të realizoj pagesen në vlerë prej **60** euro në xhirollogarinë e FTK-së si dhe vërtetimin e pagesës duhet ta paraqes në momentin e parashtrimit të ankesës. Në rast se pala e fiton kontestin, shuma e njejtë e mjeteve i kthehet në llogari palës.
- 10.5. Komisioni i Ankesave duhet të njoftohet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij, për çfarëdo ndryshimi të adresës, e-mailit apo numrit të telefonit të tij.
- 10.6. Në rastet kur ankesa është e paqartë ose e pakompletuar, Komisioni i Ankesave i dërgon palës kërkesën për plotësimin e ankesës, me sugjerimet përkatëse. Pala është e obliguar që të plotësojë ankesën brenda afatit prej tre (3) ditësh nga momenti i pranimit të kërkesës për plotësim të ankesës.
- 10.7. Nëse pala nuk e plotëson ankesën brenda afatit të përcaktuar, sipas kërkesës së Komisionit ose nuk e bënë plotësimin fare, atëherë ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.
- 10.8. Komisioni lejon ndërhyrjen e palës së tretë, nëse vlerëson se palës i cenohet e drejta që lidhet me rastin konkret, në pajtim me Statutin, këtë Rregullore dhe aktet normative përkatëse në fuqi.
- 10.9. Ankesat nuk pranohen nëse parashtrihen në kundërshtim me Statutin e FTK-së, këtë Rregullore dhe aktet normative përkatëse në fuqi. Komisioni i Ankesave obligohet ta njoftoj palën në rast se ankesa nuk pranohet.

Neni 11

Mbajtja e seancave për shqyrtimin e ankesave

- 11.1. Komisioni i Ankesave për shqyrtimin e ankesave është i obliguar që brenda afatit prej tre (3) ditësh pune nga momenti i kompletimit të ankesës (lëndës), të mbajë seancën e parë për shqyrtimin e ankesës.
- 11.2. Mbledhjet për shqyrtimin e ankesave kryesohen nga kryesuesi i Komisionit, i cili së bashku me anëtarët kujdesen për eliminimin eventual të konfliktit të interesit.
- 11.3. Në rast të mungesës së Kryesuesit, mbledhja kryesohet nga anëtari i dytë i renditur në vendimin e Kuvendit të FTK-së.
- 11.4. Komisioni i Ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesës, ka të drejtë të kërkojë nga palët, dokumente dhe informacione të nevojshme, si dhe të bëjë verifikimin e dëshmimeve dhe situatës.

Neni 12



Procesverbali

- 12.1. Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Ankesave duhet të përgatitet me shkrim nga një anëtar i caktuar nga kryesuesi i Komisionit.
Procesverbali duhet të përmbajë:
- 12.2 Datën, vendin e hartimit dhe kohën në të cilën mbledhja fillon dhe përfundon;
- 12.3 Emrat e anëtarëve të pranishëm të Komisionit;
- 12.4 Vendimet e nxjerra nga seanca;
- 12.5 Çdo votim që është bërë duke përfshirë edhe rezultatet, dhe
- 12.6 Çështje tjera relevante për rastin.
- 12.7 Procesverbali paraqitet për miratim në fund të mbledhjes përkatëse ose në fillim të mbledhjes paraardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Neni 13

Kourumi dhe vendimmarrja

- 13.1. Komisioni i Ankesave ka kuorum, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit.
- 13.2. Vendimet e Komisionit të Ankesave merren me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit të Ankesave.
- 13.3. Për të qenë i vlefshëm, një vendim i Komisionit të Ankesave duhet të jetë marrë nga të paktën dy (2) prej anëtarëve të saj.
- 13.4. Abstenimi do të llogaritet si votë kundër.
- 13.5. Komisioni i Ankesave bënë përpjekje që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të bëjë zgjidhjen e kontesteve sa më shpejtë të jetë e mundur por jo më vonë se pesëmbdhjetë (15) ditë nga data e pranimit të ankesës.
- 13.6. Vendimet e Komisionit të Ankesave nënshkruhen nga Kryesuesi i Komisionit të Ankesave.

Neni 14

Detyrimet e anëtarëve të Komisionit të Ankesave

- 14.1. Anëtarët e Komisionit të Ankesave janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhje dhe të punojnë me profesionalizëm në përputhje me Statutin, këtë Rregullore dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.



- 14.2. Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në seancë, ai ka për obligim që ta njoftoi Kryesuesin.
- 14.3. Mospjesëmarrja radhazi në tre (3) seanca të pa-arsyeshme, përbën shkak për iniciimin e procedurave të shkarkimit.
- 14.4. Anëtarët e Komisionit të Ankesave janë të detyruar të ruajnë sekretin për sa i përket vendimeve të Komisionit të Ankesave.
- 14.5. Anëtarët e Komisionit të Ankesave janë të detyruar të shmangin konfliktin e interesit gjatë gjithë procesit të zgjidhjes së kontestit.

Neni 15

Detyrimet e Palëve ndaj Komisionit të Ankesave

- 15.1. Palët janë të detyruara që të bashkëpunojnë me Komisionin e Ankesave, duke siguruar informacione dhe dokumentacion të nevojshëm lidhur me ankesat, varësisht sipas kërkesave të Komisionit të Ankesave.
- 15.2. Nëse ankesa është pranuar si e rregullt, më kërkesë të Komisionit të Ankesave, palët janë të detyruara që ti përgjigjen Komisionit me shkrim në pretendimet ankimore të palës, në afat prej tri (3) ditësh nga data e pranimit të kërkesës.

Neni 16

Efektet e Vendimeve të Komisionit të Ankesave

- 16.1. Vendimi i Komisionit të Ankesave bëhet i ekzekutueshëm nga momenti i njoftimit të palëve apo në ndonjë datë tjetër siç caktohet nga Komisioni i Ankesave.
- 16.2. Vendimet e Komisionit të Ankesave janë përfundimtare, ndërsa pala e pakënaqur ka të drejtë ushtroj ankesë në Ministrinë përkatëse për Kulturë, Rini dhe Sport, Këshillin e Arbitrazhit Sportiv-KAS në KOK
- 16.3. Ankesat ndaj vendimeve të Komisionit nuk e ndalojnë ekzekutimin e vendimit, në përjashtim të çështjeve financiare.



Neni 18 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi, pas miratimit nga Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës.

Kryetari i FTK-së
Jeton Hadërgjonaj



17 Nëntor 2022